



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 11, Datë 07.03.2014

PËR

**MIRATIMIN E INSTRUMENTIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË
FUSHË-KRUJË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 89, të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, Kreut III “Planifikimi Vendor” të VKM-së nr. 481, datë 22.06.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Instrumenteve të Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr 887, datë 03.10.2013 “Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Bashkisë Fushë-Krujë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Fushë-Krujë.
2. Pjesë përbërëse e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor janë:
 - a. Politika e Zhvillimit të Territorit,
 - b. Plani i Përgjithshëm Vendor,
 - c. Rregullorja Vendore e Planifikimit,
 - d. Materiali grafik (harta).
3. Pjesa e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor që parashikon zhvillime në kategorinë “tokë bujqësore”, sikurse evidentuar në materialin grafik përkatës, hyn në fuqi vetëm në rast se parashikimi është për zhvillime ekonomike dhe mbi të gjitha, vetëm pasi të realizohet konvertimi i kategorisë së resursit “tokë bujqësore” në kategorinë e resursit “tokë urbane”, sipas legjislacionit sektorial në fuqi.



4. Ngarkohet Bashkia Fushë-Krujë të kryejë bashkërendimin me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave në lidhje me zbatimin e pikës 3.
5. Ngarkohet Bashkia Fushë-Krujë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJERMENTI




MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



SEKRETARE E KKT

Znj. ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT